



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 9, datë 09.05.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin maj, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 11:04

Data e mbajtjes së mbledhjes : 09.05.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Zëvendëskryetari i Bashkisë Z.Renis Mullaj dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje ! Të nderuar Këshilltarë ! I nderuar Zëvendëskryetar !

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për muajin maj të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë dhe pikat më të shumta që do të shqyrtojmë sot i përkasin tërmetit të 2019. I gjithë dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga Sekretarja e Këshillit.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën në sallë.

**Dorina Milja:** Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja....mungon.....

Kryetar ke 32 këshilltarë në sallë.

(p.s. Hyri me vonesë gjatë leximit të rendit të ditës dhe votuan këshilltarët D.Luarasi dhe F.Mërkuri), pra 34 këshilltarë në sallë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit !

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojme me mbledhjen.

Për të gjithë këshilltarët që nuk janë prezantuar z.Renis Mullaj është zëvendëskryetari i ri i Bashkisë Durrës për të gjithë ata që se njohin. Meqë mungon sot kryetarja e bashkisë është present zëvendëskryetari.

Atëherë vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 4, 5, RRASHBULL, SUKTH, MANËZ DHE ISHËM, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA "ALEKSANDËR GOGA", PALLATI NR.122, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA "ALEKSANDËR GOGA" PALLATI NR.344, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL, RRUGA "GJON KASTRIOTI" PALLATI NR.39, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "HYSEN KERTUSHA" PALLATI NR.32, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "HYSEN MYSHKETA" PALLATI NR.27, I DËMTUAR NGA

projektvendimit	FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË 159 FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHËMBJES SË BANESAVE TË TYRE, SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 2'303'173'480 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.181, DATË 30.03.2022 "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUIJË"
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË DURRËS
Pika 10. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 1'633'906'424 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.255, DATË 29.04.2022 "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË DURRËS"

Këto pra ishin 10 pikat e rendit të ditës.

Nëse ka ndonjë koment nga ana këshilltarëve?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

**Dorina Milja** : Kryetar ke 34 këshilltarë.

**Ani Dyrmishi** : Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 34 vota pro miratohet rendi i ditës.*

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike me kryetare znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Faleminderit Kryetar!

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës, komisioni propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Znj. Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

**Etleva Budini** : Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike pasi shqyrtoi pikën e parë të rendit të ditës votoi unanimit për ta kaluar në votim në këshill bashkiak.

**Ani Dyrmishi** : Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

**Etleva Velçani** : Faleminderit Kryetar.

Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin vendosi me vota unanime kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Velçani.

Ndonjë koment përsa i përket pikës 1, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 34 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike me vota unanime propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Komisioni votoi unanimit për kalimin në votim të kësaj pike. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin ra dakort për kalimin në votim të pikës. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Velçani.

Ndonjë koment përsa i përket pikës 2, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 34 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Komisioni Rregullores mori në shqyrtim pikën 3 sipas relacionit dhe projektvendimit dhe propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni ynë, pasi shqyrtoi relacionin dhe materialet që kemi në dispozicion është unanimitisht për kalimin në votim në mbledhjen e këshillit bashkiak të kësaj pike.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Faleminderit.

Edhe për këtë pikë Komisioni vendosi unanimitisht për kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente ka përse i përket pikës 3 të rendit të ditës, nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 34 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike dhe për pikën 4 propozon për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni Strehimit votoj unanimitisht për kalimin e kësaj pike të rendit të ditës në këshill bashkiak.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Budini.  
Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës ra dakort për kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Velçani.  
Përsa i përket pikës 4, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.  
Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?  
Kundra?....  
Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë miratohet me 34 vota pro dhe pika 4 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim miratimin e listës në njësinë administrative nr.3 propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim pikën 5.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

**Etleva Budini** : Edhe për këtë pikë Komisioni i Strehimit ka votuar unanimit për ta kaluar në këshill bashkiak .

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Gjithashtu dhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin është dakort për kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Atëherë komente përsa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.  
Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?  
Kundra?....  
Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 34 vota pro miratohet dhe pika 5 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim dhe pikën 6 të rendit të ditës propozon për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Rroshi.  
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Edhe për këtë pikë me votim unanim Komisioni i Strehimit ra dakort për kalimin në këshill bashkiak .

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Budini.  
Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës ra dakort për kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Atëherë përsa i përket pikës 6, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.  
Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?  
Kundra?....  
Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 34 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 7**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim dhe pikën 7 të rendit të ditës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Rroshi.  
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni i Strehimit me votim unanim është për kalimin e kësaj pike të rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Komente përsa i përket pikës 7, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.  
Kush është pro miratimit të pikës 8, më falni pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 34 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.*

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 8**, i japim fjalën Komisionit Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin vendosi me vota unanime kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit znj. Velçani

Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Edhe Komisioni ynë vendosi pro miratimit të pikës 8. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Bardhaj.

Atëherë komente përse i përket pikës 8 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 34 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.*

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 9**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Komisioni Rregullores “Për miratimin e rregullores së administrimit të mbetjeve në Bashkinë Durrës” propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 9 në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni ynë pas shqyrtimit të dosjeve dhe materialeve që kishim në dispozicion jemi për ta kaluar në votim miratimin e kësaj rregullore.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve z. Agalliu.

**Tomorr Agalliu** : Faleminderit Kryetar .

Është një nga rregulloret më të rëndësishme mendoj unë se po diskutohet sot dhe kalon në Këshill Bashkiak për vetë rëndësinë që ka për cilësinë e jetës së qytetarëve, për përmirësimin e jetës, është i debatueshëm dhe me të drejtë. Falenderojmë ekipin që është marrë me hartimin e rregullores që nga baza ligjore dhe gjithë procedurat që kanë ndjekur. Jemi të bindur dhe “Ne”



si komision pasi u mblodhëm dhe diskutuam se do të ketë një impakt pozitiv për cilësinë e jetës së qytetarëve të Durrësit, jo vetëm për sezonin turistik, por dhe në vazhdimësi. Në këtë kuadër për marrëdhëniet me publikun ka rëndësi të jashtëzakondshme që qytetarët të njihen me rregulloren e re nëpërmjet tabelave, broshurave, rritjes së bashkëpunimit dhe me faktorë të tjerë, siç janë institucionet arsimore, pasi çdo familje direkt ose indirekt është e lidhur me shkollat që kjo rregullore të zbatohet dhe të ketë ato pritshmërit që “Ne” kemi. Jemi të bindur se të gjithë duhet bashkë, se këtë se bën dot askush, jemi të ndërgjegjshëm se kultura tek “Ne” mungon lidhur me këto problematikat e mbetjeve urbane. Kërkohej impenjimi i të gjithëve dhe “Ne” si komision me shpresë të madhe se të gjithë bashkë do t’ia dalim. Është një proces i vështirë, shumë i vështirë, por që mendojmë se rregullorja e re do ta përmirësojë dukshëm cilësinë e jetës së qytetarit, pasi lidhet me tokën, me ujën me ajrin, me diellin e të tjera me radhë. Ju faleminderit dhe kërkohej bashkëpunimi i të gjithë faktorëve për zbatimin e kësaj rregullore. Komisioni unanimisht e votoi.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit z. Agalliu.

Atëherë përse i përket pikës 9, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

**Dorina Milja** : Kryetar ke 33 këshilltarë në sallë (*largohet nga salla këshilltari A. Mullaraj*).

**Ani Dyrmishi** : Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 10**, i japim fjalën Komisionit Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës mori në shqyrtim pikën 10 të rendit të ditës “Për miratimin e përdorimit dhe detajimit të fondit prej 1’633’906’424 lekë pa tvsh, për financimin e rirforcimit të njërive individuale të banimit dhe njërive të banimit”.

Nga sa më sipër komisioni vendosi me vota unanime kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit znj. Velçani

Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Edhe Komisioni ynë vendosi pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Bardhaj.

Atëherë përse i përket pikës 10, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 dhe të fundit të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 33 vota pro miratohet dhe pika 10 dhe e fundit e rendit ditës.

Duke Ju falenduar për pjesmarrjen, faleminderit Këshilltarëve, Zëvendëskryetarit, mediave, të gjithëve.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur dhe do njoftoheni për mbledhjet e tjera me rrugë elektronike nga ana e Sekretarisë së Këshillit.

Ju faleminderit.

*Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 10(dhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit.*

**Mbajtësi i procesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Përfaqësues i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ALNEIDA RRROSHI

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI